

DEKRET
Nr. 11199, datë 10.6.2019

**PËR SHFUQIZIMIN E DEKRETIT NR. 10928, DATË 5.11.2018 TË PRESIDENTIT
TË REPUBLIKËS “PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE”**

Në mbështetje të nenit 1/3, 3, 4/2, 15, 45, 86/1, 92, shkronja “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 5.11.2018 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, duke anuluar datën 30 qershor 2019, si ditë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Dekreti dërgohet për zbatim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, i cili merr masat për t’ia njoftuar këtë akt të gjitha subjekteve zgjedhore.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Ilir Meta